

# KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT BUJQËSORE INDEKS NË BAZË TË MOTIT

## 1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1.1. Kushtet e përgjithshme të kontratës për sigurim bujqësor indeks, këtu më poshtë do të quhen shkurtimisht "Kushtet e Sigurimit" janë hartuar në bazë të dispozitave ligjore të ligjit relevant për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe dispozitave të tjera që mbulojnë sigurimet në përgjithësi.

1.2. Kompania e sigurimit që ofron mbulesën siguruese këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht "Siguruesi".

1.3. Personi fizik ose juridik, interesi pasuror i të cilit do të mbulohet sipas këtyre Kushteve të përgjithshme këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht "i Siguruari".

1.4. Personi fizik ose juridik i përcaktuar në Policën e sigurimit dhe në dobi të të cilit lidhet kontrata, këtu më poshtë do të quhet "Përfituesi".

## 2. QËLLIMI I MARRËVESHJES SË SIGURIMIT

2.1. Qëllimi i marrëveshjes siguruese është mbrojtja e interesit pasuror i të siguruarit i cili nuk bie në kundërshtim me kornizën ligjore që rregullon sigurimet bujqësore dhe ligjet dhe rregulloret tjera që rregullojnë këtë fushë, përdorimi dhe disponimi i kulturave bujqësore, siç është përcaktuar në marrëveshjen e sigurimit në rastet e paraqitjes së ngjarjeve me të cilat shkaktohen humbje si rezultat i rreziqeve të mbuluara, siç është përcaktuar në këto kushtet.

## 3. OBJEKTI I SIGURIMIT

3.1. Siguruesi ofron mbulesë siguruese standarde, në përputhje me kriteret, kufijtë, shumat e sigurimit dhe primet e përcaktuara në Shtojcën I dhe Shtojcën II të Këtyre Kushteve të Përgjithshme për vitin kalendarik të përcaktuar në polisën e sigurimit për kulturat e mëposhtme:

3.2.1. Molla;

3.2.2. Speci;

3.2.3. Mjedra;

3.2.4. Dredhëza;

3.2.5. Rrushi i verës;

3.2.6. Kumbulla.

3.3. Kulturat e siguruar, sipas kriterëve të përcaktuar në Kushtet e Përgjithshme, do të konsiderohen ato kultura që rriten në zona (fusha) të veçanta brenda njësisë administrative.

## 4. RREZIQET DHE NGJARJET E SIGURUARA

4.1. Do të konsiderohen rreziqe të siguruar vetëm rreziqet e përcaktuara në policën e sigurimit.

4.2. Ngjarje të siguruar është ngjarja e përcaktuar nga marrëveshja e sigurimit që ka ndodhur dhe me

paraqitjes e së cilës siguruesi është i detyruar të paguajë pagesën e dëmshpërblimit për të siguruarin ose përfituesin në përputhje me kushtet e marrëveshjes së sigurimit për dëmin material që është shkaktuar si rezultat i ngjarjeve të sigurimit të përcaktuara në marrëveshjen e sigurimit që mund të rezultojë në humbje financiare për të siguruarin të përcaktuar në marrëveshjen e sigurimit.

4.3. Ngjarja e siguruar do të thotë ngjarja që ndodh si pasoje e rreziqeve të mbuluara shprehimisht në police të sigurimit brenda periudhës së mbuluar nga polica e sigurimit.

## **5. PËRCAKTIMI I SHUMËS SË SIGURUAR DHE MBULIMI I SIGURIMIT**

5.1. Shuma e sigurimit është shuma monetare brenda së cilës siguruesi sipas marrëveshjes së sigurimit është i detyruar të bëjë pagesën e sigurimit të siguruarit me rastin e paraqitjes së ngjarjes e cila është siguruar.

5.2. Shuma e sigurimit / Kosto e prodhimit përcaktohet në bazë të kostove operacionale për prodhimin e kulturave bujqësore, në varësi të teknologjisë së prodhimit të përdorur nga i siguruari.

5.3. Shuma totale e sigurimit sipas këtyre Kushteve të Përgjithshme është përcaktuar në Polisën e Sigurimit.

5.4. Kufijtë dhe limitet e pagesave për secilin produkt janë paraqitur në Shtojcën I të Kushteve të Përgjithshme.

## **6. TARIFAT E SIGURIMIT DHE PAGESA SIGURUESE**

6.1. Primi i sigurimit bujqësor standard përcaktohet sipas Broshurës së Çmimeve të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin aktual për çdo kulturë bujqësore.

6.2. Primi i sigurimit duhet të paguhet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës së sigurimit në të kundërtën, kontratën e sigurimit nuk fuqizohet. (Numri i ditëve do të diskutohet dhe vendoset nga Kompanitë e Sigurimit)

6.3. Shuma e primit të sigurimit është e përcaktuar me policen e Sigurimit. Pagesa e premisë së sigurimit duhet të bëhet në llogarinë bankare të Siguruesit të paraqitur në Faturë.

6.4. Pagesa do të konsiderohet e plotë në momentin e kalimit të shumës së paguar në llogarinë e Primit të sigurimit paguhet në monedhën e specifikuar në policen e sigurimeve. Primi i sigurimit mund të paguhet në tërësi ose në këste, siç është rënë dakord midis palëve kontraktuese.

6.5. Në rastin e pagesës së premisë së sigurimit me këste, nëse premia ose kësti i parë nuk paguhet me kohë, mbulimi i sigurimit shuhet konform dispozitave ligjore të Nenit 934 të Ligjit Nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve në Kosovë.

6.6. Kur i siguruari nuk paguan shumën e vazhdueshme në afatet e përcaktuara në police të sigurimit, sigurimi pezullohet nga ora 24:00 pas përfundimit të afatit të pagesës dhe siguruesi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e marrëveshjes së sigurimit. (Do të harmonizohet me 5.1 pasi të vendoset nga Kompanitë e Sigurimit)

6.8. Siguruesi do të paguajë vetëm dëmet në proporcion me përqindjen e premisë së paguar.

## **7. PERIUDHA E SIGURIMIT**

7.1. Marrëveshja e sigurimit hyn në fuqi në datën e përcaktuar në police të sigurimit si datë e fillimit menjëherë pas nënshkrimit të polices së Sigurimit me kusht që të jete pranuar nga Siguruesi primi i sigurimit.

7.2. Marrëveshja e sigurimit skadon në orën 24:00 të datës së përcaktuar në marrëveshjen e sigurimit si datë e skadimit ose pasi që të jetë paguar dëmshpërblimi për policen e sigurimit në masën 100% të shumës së siguruar.

## **8. PROCEDURA PËR PËRFUNDIMIN E MARRËVESHJES**

8.1. I siguruari plotëson, nënshkruan dhe dërgon formularin e aplikimit tek siguruesi në kohën e duhur dhe jo më vonë se 5 ditë para datës së fillimit të periudhës siguruese.

8.2. I siguruari është përgjegjës për saktësinë dhe vërtetësinë e raporteve dhe deklaratave të bëra prej tij.

## **9. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE**

9.1. Siguruesi ka të drejtë të:

9.1.1. Të transferojë të drejtat dhe / ose detyrimet e tij, me përjashtim të detyrimit për të paguar dëmin e sigurimit;

9.1.2. Të filloj ndryshimet dhe plotësimet e kësaj marrëveshje të sigurimit;

9.1.3. Fillimin e zbatimit të marrëveshjes së sigurimit.

9.1.4. Verifikimin e saktësisë së informacioneve të dhëna nga Sistemi dhe të kryej inspektimet për verifikimin e saktësisë së të dhënave.

9.2. Siguruesi duhet të:

9.2.1. Informojë të siguarin mbi detyrat dhe të drejtat, dhe të sigurojë Kushtet e Përgjithshme të Sigurimit sipas Indeksit të Motit para nënshkrimit të Polisës së Sigurimit.

9.2.2. Shqyrtoj dokumentacionin për pagesën e dëmshpërblimit në kohë,

9.2.3. Kryej pagesën e dëmshpërblimit në kohë,

9.2.4. Të mos publikoj të dhënat për të drejtat e siguruara dhe të drejtat e tij / saj

9.3. I siguruari ka të drejtë të:

9.3.1. Merr pagesën e dëmshpërblimit,

9.3.2. Fillimin e zbatimit të marrëveshjes së sigurimit,

9.3.3. Në rast se versioni origjinal i marrëveshjes është i humbur për të marrë një tjetër,

9.3.4. Filloj ndryshimet dhe plotësimet e kësaj marrëveshje të sigurimit.

9.4. I siguruari duhet të:

9.4.1. Paguaj shumën e primin të sigurimit në shumën dhe brenda afatit kohor të përcaktuar në marrëveshjen e sigurimit;

9.4.2. Informoj siguruesin për të gjitha kontratat e zbatueshme të sigurimit të lidhura në lidhje me objektin e kësaj marrëveshjeje;

## **10. NJOFTIMI PËR KËRKESËN NË LIDHJE ME DËMIN**

10.1. Procesi i njoftimit të kërkesave në lidhje me dëmin automatizohet përmes sistemit elektronik dhe sapo të ndodh ngjarja, informacioni i mëposhtëm do të raportohet automatikisht tek Siguruesi:

10.1.1. Numri i referencës së kërkesës;

10.1.2. Emri i të siguarit;

10.1.3. Lloji i sigurimit;

10.1.4. Numri i Polisave të Sigurimit;

10.1.5. Data e Humbjes;

10.1.6. Data e raportimit;

10.1.7. Vendi i Ngjarjes;

10.1.8. Periudha e mbulimit të Polisës së Sigurimit;

10.1.9. Humbja e parashikuar;

10.1.10. Shuma e përcaktuar; dhe

10.1.11. Data e Zgjidhjes së rastit.

## **11. PRANUESHMËRIA E TË DHËNAVE**

11.1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, parametrat e rrezikut do të vlerësohen duke përdorur të dhënat e motit vetëm nga MeteoGroup si një institucion i besueshëm dhe profesional, i njohur dhe i pranueshëm nga të gjitha palët e interesuara.

## **12. PËRCAKTIMI I HUMBJEVE DHE PAGESA E DËMSPËRBLIMIT**

12.1. Humbja përcaktohet për secilën pike (grid) dhe për çdo kulturë bujqësore në bazë të shumës së përcaktuar Broshurën në lidhje me përcaktimin e humbjeve.

12.2. Llogaritja e dëmshpërblimit do të bëhet në bazë të Broshurës për përcaktimin e humbjeve për çdo kulturë siç është përcaktuar në Shtojcën II.

12.3. Siguruesi, pas marrjes së njoftimit të kërkesës, duhet të kryejë pagesën e dëmshpërblimit brenda pesëmbëdhjetë ditëve të punës nga data e njoftimit të ngjarjes.

12.4. Refuzimi i siguruesit për të paguar dëmshpërblimin mund të kontestohet sipas kërkesave të këtyre Kushteve të Përgjithshme.

### **13. PROCUDERA PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES**

13.2. Çdo ndryshim, modifikim, rishikim ose ndryshim i marrëveshjes së sigurimit të cilat bëhen si rezultat i pajtimit të të dyja palëve do të inkorporohet në këtë marrëveshje me shkrim dhe do të hyj në fuqi kur të nënshkruhet nga të dyja palët e kësaj marrëveshje të sigurimit.

### **14. ZGJIDHJA E MARRËVESHJES SË SIGURIMIT**

14.1. Marrëveshja e sigurimit shkëputet me pëlqimin e palëve, si dhe në rastin e:

14.1.1. skadimit të afatit të marrëveshjes;

14.1.2. ekzekutimin i plotë i detyrimeve të Siguruesit kundrejt të siguruarit;

14.1.3. mos pagesa e shumës së primit nga ana e të siguruarit në bazë të periudhave të përcaktuara me këtë marrëveshjet të sigurimit.

14.1.4. likuidimi i Siguruesit;

14.1.5. zbatimit të vendimit të gjykatës lidhur me pavlefshmërinë e marrëveshjes së sigurimit;

14.1.6. në raste të tjera të përcaktuara me legjislacionin e Kosovës.

14.2. Marrëveshja e sigurimit mund të ndërpritet në çdo kohë me kërkesën e njëjës prej palëve mbi detyrimin e njoftimit 30 ditë para përfundimit.

14.3. Në rast të anulimit të marrëveshjes së sigurimit me kërkesën e të siguruarit, siguruesi do të mbaj shumën e primit për marrëveshjen e sigurimit të kohës në fuqi dhe 20% të primit të sigurimit të papërdorur, për shpenzimet administrative. Nëse i siguruari kërkon ndërprerjen e marrëveshjes së sigurimit për shkak të shkeljes së bërë nga siguruesi, ky i fundit duhet t'i kthejë sigurimit pagesat e sigurimit të paguara nga i siguruari në tërësi.

14.4. Marrëveshja e sigurimit mund të ndërpritet në çdo kohë me vullnetin e siguruesit duke njoftuar të siguruarin lidhur me këtë ndërprerje dhe në këtë rast siguruesi do të jetë i detyruar të kthejë shpërblimin në përpjesëtim me kohën e mbetur nga anulimi i marrëveshjes së sigurimit deri në përfundimin e tij.

### **15. JURISDIKSIONI**

15.1. Palët pajtohen që në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me marrëveshjen e sigurimit, marrëveshja e sigurimit rregullohet në të gjitha aspektet nga Legjislacioni i Kosovës pa dhënë efektin e ndonjë parimi që mund të parashikojë zbatimin e ligjit të një juridiksioni tjetër.

### **16. ZGJIDHJA E KONTESTEVE**

16.1. Çdo mosmarrëveshje, kontest ose kërkesë që rrjedh nga ose në lidhje me kushtet e përcaktuara në marrëveshjen e sigurimit, duke përfshirë vlefshmërinë, pavlefshmërinë, shkeljen ose përfundimin e

saj, zgjidhet nga Departamenti relevant i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

## **17. TRANSFERIMI I TË DREJTAVE**

17.1. Marrëveshja e sigurimit dhe të gjitha të drejtat, të gjitha detyrat në vijim janë personale për të siguruarit dhe siguruesit dhe pa pëlqimin me shkrim të siguruesit, nuk lejohen ose refuzohen në diskrecionin e vetëm dhe absolut të siguruesit, të caktohen, lihen hipotekë, nën-licencohen ose të ngarkohen nga të siguruarit ose nga përcaktimet me ligj.

## **18. DISPOZITAT TJERA**

18.1. Çdo njoftim ose komunikim i kërkuar ose i lejuar sipas marrëveshjes së sigurimit do të jepet në brenda afatit të mjaftueshme nëse dorëzohet personalisht ose me postë të vërtetuar, faturën e kthimit të kërkuar, në adresat e listuara në marrëveshjen e sigurimit ose në atë adresë tjetër siç mund t'i ketë paraqitur njëra palë - palës tjetër shkrim. Njoftimi do të konsiderohet i pranuar kur të dorëzohet ose të nënshkruhet, ose në ditën e tretë pas postimit nëse nuk është nënshkruar.

18.2. Marrëveshja e sigurimit zëvendëson çdo marrëveshje paraprake me shkrim ose gojore ndërmjet palëve. Forma e aplikimit, Kushte të përgjithshme, njoftimet dhe deklaratat e tjera të të siguruarit i bashkëngjiten kontratës së sigurimit dhe janë pjesë përbërëse e saj.

18.3. Nëse ndonjë dispozitë e marrëveshjes së sigurimit do të konsiderohet e pavlefshme ose e pazbatueshme për çfarëdo arsye, dispozitat e mbetura do të vazhdojnë të jenë të vlefshme dhe të zbatueshme. Nëse një gjykata e arbitrazhit konstaton se çdo dispozitë e marrëveshjes së sigurimit është e pavlefshme ose e pazbatueshme, por duke kufizuar një dispozitë të tillë ajo do të bëhej e vlefshme dhe e zbatueshme, atëherë dispozita e tillë konsiderohet të jetë e shkruar, interpretuar dhe zbatuar në mënyrë të kufizuar.

## SHTOJCA I - KUFIJTË DHE LIMITET E PAGESAVE

### Kufijtë dhe limitet e pagesave për mollën

Tabela në vijim paraqet përmbledhjen e rreziqeve dhe kufijve për secilën periudhë të rrezikut.

Periudha	Rreziqet	Temperatura/Grada °C	% e dëmit për ditë
20 marsi - 9 prill	Ngricat pranverore (Faza I)	$\leq -5$	10%
10 prill - 30 prill	Ngricat pranverore (faza II)	$\leq -4$ por $> -5$	25%
		$\leq -5$ por $> -6$	50%
		$\leq -6$	100%
1 maj - 15 maj	Ngricat pranverore (Faza III)	$\leq -1$ por $> -2$	25%
		$\leq -2$ por $> -3$	50%
		$\leq -3$	100%

### Kufijtë dhe limitet e pagesave për specin

Tabela në vijim paraqet përmbledhjen e rreziqeve, kufijeve dhe limitet e pagesave për secilën periudhë të rrezikut.

Periudha	Rreziqet	Kufiri (reshjet e grumbulluara)	Pagesa e dëmshpërblimit
15 maj - 10 qershor	Reshjet e mëdha	110mm	20% pas 110mm dhe 20% për cdo 10mm mbi 110mm

### Kufijtë dhe limitet e pagesave për mjedrën

Tabela në vijim paraqet përmbledhjen e rreziqeve, kufijeve dhe limitet e pagesave për secilën periudhë të rrezikut.

Periudha	Rreziqet	Temperatura/Grada në °C	% e dëmit për ditë
1 korrik - 31 gusht	Temperaturat ekstreme të larta	$\geq +29^{\circ}$	Për 10 ditë - 50% Pas 10 ditëve - 5% për secilën ditë

### Kufijtë dhe limitet e pagesave për dredhëzën

Tabela në vijim paraqet përmbledhjen e rreziqeve, kufijeve dhe limitet e pagesave për secilën periudhë të rrezikut.

Periudha	Rreziqet	Temperatura/Grada në °C	% e dëmit për ditë
1 mars - 14 mars	Ngrica pranverore - Faza I	$\leq -10$	5%
15 mars - 31 mars	Ngrica pranverore - Faza II	$\leq -5$ por $> -6$	25%
		$\leq -6$ por $> -7$	50%
		$\leq -7$	100%
1 prill - 30 prill	Ngricat pranverore - Faza III	$\leq -6$ por $> -7$	50%
		$\leq -7$	100%

### Kufijtë dhe limitet e pagesave për rrushin

Tabela në vijim paraqet përmbledhjen e rreziqeve dhe kufijeve për secilën periudhë të rrezikut.

Periudha	Rreziqet	Temperatura °C / Numri i ditëve me shi	% e dëmit për ditë
1 dhjetor - 19 mars	Temperaturat jashtëzakonisht të ulëta	$\leq -30$	100%
20 marsi - 9 prill	Ngricat pranverore (Faza I)	$\leq -5$ por $> -6$	40%
		$\leq -6$ por $> -7$	60%
		$\leq -7$	80%
10 prill - 30 prill	Ngricat pranverore (Faza II)	$\leq -2$ por $> -3$	25%
		$\leq -3$ por $> -4$	50%
		$\leq -4$	70%
1 maj - 14 maj	Ngricat pranverore (Faza III)	$\leq -1$ por $> -2$	25%
		$\leq -2$ por $> -3$	50%
		$\leq -3$	80%

### Kufijtë dhe limitet e pagesave për kumbullën

Tabela në vijim paraqet përmbledhjen e rreziqeve dhe kufijte për secilën periudhë të rrezikut.

Periudha	Rreziqet	Temperatura/Grada në °C	% e dëmit për ditë
20 mars - 9 prill	Ngricat pranverore (Faza I)	$\leq -5$	10%
10 prill - 30 prill	Ngricat pranverore (Faza II)	$\leq -4$ por $> -5$	25 %
		$\leq -5$ por $> -6$	50 %
		$\leq -6$	100 %
1 maj - 15 maj	Ngricat pranverore (Faza III)	$\leq -1$ por $> -2$	25 %
		$\leq -2$ por $> -3$	50 %
		$\leq -3$	100 %



## SHTOJCA II - LLOGARITJA E DËMSHPËRBLIMIT

### Llogaritja e pagesës

Bazuar në periudhën e rrezikut, kufijeve, ditët dhe lokacionin, sistemi do të jetë në gjendje të llogarisë pagesën e dëmshpërblimit. Shkurtesat në vijim do të përdoren nëpër tërë këtë dokument për qëllime demonstrimi:

- Temperatura minimale - T<sub>min</sub>
- Numri i ditëve të njëpasnjëshme të nxitura - NC
- Kufiri - Trig
- Llogaritja e dëmshpërblimit - LID
- Pagesa e dëmshpërblimit - PD
- Rrumbullakësimi i pagesës - rd

### 1. Llogaritja e dëmshpërblimit për mollën

#### Pagesa e dëmshpërblimit për ngricat pranverore (Faza I)

Gjatë periudhës 20 mars - 9 prill, sythat janë në rrezik nga ngricat pranverore dhe si pasojë mund të krijohen humbje te molla. Pagesa e dëmshpërblimit do të llogaritet sipas numrit të ditëve të nxitura dhe pagesës përkatëse të dëmshpërblimit.

Kufiri për këtë periudhë të mbulimit llogaritet në  $\leq -5^{\circ}\text{C}$ . Nëse temperatura është  $-5^{\circ}\text{C}$  ose më poshtë, pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 10%, për secilën ditë dhe për secilën gradë.

Në rast se temperatura minimale e ditës nuk është nxitur, nuk do të ketë dëmshpërblim në dispozicion.

Formula për llogaritjen e pagesës së dëmshpërblimit është:

$$\text{LID} = \sum(((-rd(T_{\min})) + (\text{Trig})) \times \text{PD} + \text{PD})$$

Shembull: Nëse nga marsi - prill (gjatë periudhës së mbulimit për ngricat pranverore) temperatura minimale ditore është  $-6.9^{\circ}\text{C}$  për një ditë dhe  $-5^{\circ}\text{C}$  për 2 ditë, atëherë llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit do të bëhet si në vijim:

$$1(((-rd)(-6.9^{\circ}\text{C}) + (-5^{\circ}\text{C})) \times 10\% + 10\%) + 2(((-rd)(-5^{\circ}\text{C}) + (-5^{\circ}\text{C})) \times 10\% + 10\%) =$$

$$1((6 - 5) \times 10\% + 10\%) + 2((5 - 5) \times 10\% + 10\%) =$$

$$1(1 \times 10\% + 10\%) + 2(0 \times 10\% + 10\%) = 1 \times 20\% + 2 \times 10\% = 40\%$$

Shuma maksimale e pagesës për polisën e sigurimit nuk mund të kalojë 100% e shumës së siguruar.

Nëse i siguruari merr 100% të pagesës së dëmshpërblimit për cilëndo periudhë të rrezikut, nuk do të bëhet asnjë pagesë tjetër për rreziqet e tjera edhe nëse ka ngjarje të tjera të kufijve. (provokuara).

## Llogaritja e dëmshpërblimit për ngricat pranverore (Faza II)

Gjatë periudhës 10 prill – 30 prill , sythat dhe lulet e mollëve janë në rrezik nga ngrica pranverore dhe si pasojë mund të krijohen humbje te mollës. Pagesa e dëmshpërblimit do të llogaritet sipas numrit të ditëve të nxitura dhe pagesës përkatëse të dëmshpërblimit.

Kufiri për këtë periudhë të mbulimit llogaritet në  $-4^{\circ}\text{C}$ . Nëse temperatura minimale ditore është e barabartë ose nën  $-4^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 25% për çdo ditë. Nëse temperatura ditore është e barabartë ose nën  $-5^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 50% për çdo ditë. Nëse temperatura minimale ditore është e barabartë ose nën  $-6^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 100%.

Në rast se temperatura minimale e ditës nuk është nxitur, nuk do të ketë dëmshpërblim në dispozicion.

Formula për llogaritjen e pagesës së dëmshpërblimit është:

$$LID = \sum_n (((-rd(T_{min})) + (Trig)) \times PD + PD)$$

Shembull: Nëse nga 1 maji – 15 maj (gjatë periudhës së mbulimit për ngricat pranverore) temperatura minimale ditore është  $-4.5^{\circ}\text{C}$  për një ditë, atëherë llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit do të bëhet si në vijim:

$$1((( -rd) (-4.5^{\circ}\text{C}) + (-4^{\circ}\text{C})) \times 25\% + 25\%) = 1((4 - 4) \times 25\% + 25\%) =$$

$$1(0 \times 25\% + 25\%) = 0 + 25\% = 25\%$$

## Llogaritja e dëmshpërblimit për ngricat pranverore (Faza III)

Gjatë muajit maj, sythat dhe frutat e mollëve janë në rrezik nga ngricat pranverore dhe si pasojë mund të krijohen humbje te molla. Pagesa e dëmshpërblimit do të llogaritet sipas numrit të ditëve të nxitura dhe pagesës përkatëse të dëmshpërblimit.

Nëse temperatura minimale ditore është e barabartë ose nën  $-1^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 25% për çdo ditë. Nëse temperatura minimale ditore është e barabartë ose nën  $-2^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 50% për çdo ditë. Nëse temperatura minimale ditore është e barabartë ose nën  $-3^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 100% për një ditë.

Në rast se temperatura minimale e ditës nuk është nxitur, nuk do të ketë dëmshpërblim në dispozicion.

Formula për llogaritjen e pagesës së dëmshpërblimit është:

$$LID = \sum_n (((-rd(T_{min})) + (Trig)) \times PD + PD)$$

Shembull: Nëse gjatë majit (gjatë periudhës së mbulimit për ngricat pranverore) temperatura minimale ditore është  $-1.2^{\circ}\text{C}$  për dy ditë, dhe  $-2^{\circ}\text{C}$  për një ditë, atëherë llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit do të bëhet si në vijim:

$$2((( -rd) (-1.2^{\circ}\text{C}) + (-1^{\circ}\text{C})) \times 25\% + 25\%) + 1((( -rd) (-2) + (-2)) \times 50\% + 50\%) =$$

$$2((1 - 1) \times 25\% + 25\%) + 1((2 - 2) \times 50\% + 50\%) =$$

$$2(0 \times 25\% + 25\%) + (0 \times 50\% + 50\%) = 50\% + 50\% = 100\%$$

## Pagesa totale e dëmshpërblimit

Shuma maksimale e pagesës për polisën e sigurimit nuk mund të kalojë 100% e shumës së siguruar.

**IP = IF(Ilogaritja e dëmshpërblimit për fazën I të ngricave pranverore + Ilogaritja e dëmshpërblimit për fazën II të ngricave pranverore+ Ilogaritja e dëmshpërblimit për fazën III të ngricave pranverore)>100%, ATËHERË 100%**

Bazuar në shembujt, pagesa totale e dëmshpërblimit do të jetë:

$$PD= 50\% + 40\% + 25\% + 100\% = 100\%$$

## 2. Llogaritja e dëmshpërblimit për specin

### Llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit për shkak të reshjeve të tepërta të shiut

Gjatë muajit maj, qershor, specat janë në rreziknga reshjet e tepërta të shiut, dhe si pasojë fruti i specit mund të dëmtohet. Pagesa e dëmshpërblimit do të llogaritet bazuar në nivelin e grumbulluar të shiut të rënë sipas vlerave të paraqitura në tabelën më lartë.

Në rast se nuk janë nxitur reshjet e akumuluar, nuk do të ketë dëmshpërblim në dispozicion.

Formula për kalkulimin e dëmshpërblimeve si pasojë e reshjeve të mëdha për këtë periudhë të mbulimit është përshkruar më poshtë:

$$IC= \sum rd((reshjet\ e\ grumb - Trig)/10) \times PDmm + PDmm$$

Shembull: Nëse gjatë periudhës së mbulimit, do të ketë reshje të tepërta të shiut në nivel 120.5 mm llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit do të jetë:

$$rd((120.5 - 110)/10 \times 20\%) + 20\% =$$

$$rd((10.5)/10 \times 20\%) + 20\% = rd(1) \times 20\%+20\% = 1 \times 20\%+20\% = 40\%$$

Shuma maksimale e pagesës për polisën e sigurimit nuk mund të kalojë 100% e shumës së siguruar.

Nëse i siguruari merr 100% të pagesës së dëmshpërblimit për cilëndo periudhë të rrezikut, nuk do të bëhet asnjë pagesë tjetër për rreziqet e tjera edhe nëse ka ndodhur ndonjë ngjarje tjetër e siguruar.

## 3. Llogaritja e dëmshpërblimit për mjedrën

### Llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit për temperaturat ekstreme të larta

Gjatë periudhës nga 1 korriku – 31 gushti, mjedra mund të ekspozohet temperaturave të larta, dhe si pasojë këto temperatura mund të shkaktojnë zvogëlimin e rendimentit të frutit të mjedrës. Pagesa e dëmshpërblimit do të llogaritet sipas numrit të ditëve të prekura dhe përqindjeve të dëmeve të përcaktuara në tabelën më lartë.

Kufiri i dëmshpërblimit për këtë periudhë të mbulimit llogaritet nga temperatura >+29°C. Nëse

temperatura maksimale ditore është më e lartë ose e barabartë me +29°C për 10 ditë konsektive, pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 50% e kostos së prodhimit, dhe për secilën ditë pas 10 ditëshit të parë në vazhdimësi, pagesa do të 5% për ditë.

Formula për kalkulimin e dëmshpërblimeve si pasojë e temperaturave të larta ekstrme për këtë periudhë të mbulimit është përshkruar më poshtë:

$$PD = \sum (nc \times Trig1 + (nd \times Trig2))$$

Në rast se temperatura maksimale e ditës nuk është prekur, nuk do të ketë dëmshpërblim në dispozicion.

**Shembull:** Nëse gjatë periudhës, 1 korrik - 31 gusht, temperaturat janë më lartë ose të barabarta me kufirin +29°C për 10 ditë të njëpasnjëshme, dhe 2 ditë pas 10 ditëve temperatura është +31°C atëherë llogaritja do të bëhet si në vijim:

$$PD = (10 \text{ ditë} \times 50\%) + (2 \text{ ditë} \times 5\%) = 50\% + 10\% = 60\%$$

Shuma maksimale e pagesës për polisën e sigurimit nuk mund të tejkalojë 100% e shumës së siguruar.

#### 4. Llogaritja e dëmshpërblimit për dredhëzën

##### Llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit për ngricat pranverore (Faza I)

Gjatë periudhës nga 1 marsi - 14 marsi, sythat dhe frutat e dredhëzave janë në rrezik nga faza e temperaturave të ulëta dimërore, dhe si pasojë fruti i dredhëzave mund të dëmtohet. Pagesa e dëmshpërblimit do të llogaritet sipas numrit të ditëve të prekura dhe përqindjeve të dëmeve të përcaktuara në tabelën më lartë.

Kufiri për këtë periudhë të mbulimit fillon të llogaritet nga barabartë ose -10°C. Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me -10°C, pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 5%, për secilën ditë dhe për secilën gradë nën -10°C.

$$LID = n \times PD \text{ për ditë}$$

Në rast se temperatura minimale e ditës nuk është prekur, nuk do të ketë dëmshpërblim në dispozicion.

Shembull: Nëse në periudhën nga 1 marsi - 14 mars (gjatë periudhës së mbulimit për temperaturat e ulëta dimërore) temperatura minimale ditore është -11.6°C për një ditë dhe kur -12.2°C për 2 ditë, atëherë llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit do të bëhet si në vijim:

$$\text{Numri i ditëve nën kufirin për PD për ditë} = 3 \text{ ditë} \times 10\% = 30\%$$

Shuma maksimale e pagesës për polisën e sigurimit nuk mund të kalojë 100% e shumës së siguruar.

##### Llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit për ngricat pranverore (Faza II)

Gjatë periudhës nga 15 marsi - 31 mars, frutat e dredhëzave janë në rrezik nga faza I e ngricës pranverore, dhe si pasojë frutat mund të dëmtohen. Pagesa e dëmshpërblimit do të llogaritet sipas numrit të ditëve të prekura dhe përqindjeve të dëmeve të përcaktuara në tabelën më lartë.

Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-5^{\circ}\text{C}$  në ditë por më e lartë se  $-6^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 25% për cdo ditë. Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë ose nën  $-6^{\circ}\text{C}$  por më e lartë se  $-7^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 50% për secilën ditë. Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-7^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 100%.

Në rast se temperatura minimale e ditës nuk është prekur, nuk do të ketë dëmshpërblim në dispozicion.

Formula për kalkulimin e dëmshpërblimeve si pasojë e ngricave pranverore për këtë periudhë të mbulimit është përshkruar më poshtë:

$$\text{LID} = \sum_n (((-rd(T_{\min})) + (Trig)) \times PD + PD)$$

Shembull: Nëse nga 15 marsi – 31 mars (gjatë periudhës së mbulimit për ngricat pranverore) temperatura minimale ditore është  $-5.5^{\circ}\text{C}$  për një ditë, atëherë llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit do të bëhet si në vijim:

$$1((( -rd) (-5.5^{\circ}\text{C}) + (-5^{\circ}\text{C})) \times 25\% + 25\%) = 1(((5) + (-5)) \times 25\% + 25\%) =$$

$$1((3-3) \times 25\% + 25\%) = 0 \times 25\% + 25\% = 0 + 25\% = 25\%$$

Shuma maksimale e pagesës për polisën e sigurimit nuk mund të kalojë 100% e shumës së siguruar.

Nëse i siguruari merr 100% të pagesës së dëmshpërblimit për cilëndo periudhë të rrezikut, nuk do të bëhet asnjë pagesë tjetër për rreziqet e tjera edhe nëse ka ndodhur ndonjë ngjarje tjetër e siguruar.

### **Llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit për ngricat pranverore (Faza III)**

Gjatë muajit të prillit, frutat e dredhëzave janë në rrezik nga faza II e ngricës pranverore, dhe si pasojë frutat mund të dëmtohen. Pagesa e dëmshpërblimit do të llogaritet sipas numrit të ditëve të prekuara dhe përqindjeve të dëmeve të përcaktuara në tabelën më lartë.

Kufiri për këtë periudhë të mbulimit fillon të llogaritet nga barabarë ose  $-6^{\circ}\text{C}$ . Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-6^{\circ}\text{C}$  por më e lartë se  $-7^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 50% për secilën ditë. Nëse temperatura është më e ulët ose e barabartë me  $-7^{\circ}\text{C}$  në ditë, pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 100%.

Në rast se temperatura minimale e ditës nuk është prekur, nuk do të ketë dëmshpërblim në dispozicion.

Formula për kalkulimin e dëmshpërblimeve si pasojë e ngricave pranverore për këtë periudhë të mbulimit është përshkruar më poshtë:

$$\text{LID} = \sum_n (((-rd(T_{\min})) + (Trig)) \times PD + PD)$$

Shembull: Nëse gjatë prillit (gjatë periudhës së mbulimit për ngricat pranverore) temperatura minimale ditore është  $-6.2^{\circ}\text{C}$  për dy ditë, atëherë llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit do të bëhet si në vijim:

$$1((( -rd) (-6.2^{\circ}\text{C}) + (-6^{\circ}\text{C})) \times 50\% + 50\%) =$$

$$1((6) + (-6)) \times 50\% + 50\%) = 1(0 \times 50\% + 50\%) = 0 + 50\% = 50\%$$

## Pagesa totale e dëmshpërblimit

Shuma maksimale e pagesës për polisën e sigurimit nuk mund të kalojë 100% e shumës së siguruar.

**PD = IF (Ilogaritja e dëmshpërblimit për temperaturat e ulëta dimërore + Ilogaritja e dëmshpërblimit për fazën I të ngricave pranverore + Ilogaritja e dëmshpërblimit për fazën II të ngricave pranverore) > 100%, ATËHERË 100%**

Bazuar në shembujt, pagesa totale e dëmshpërblimit do të jetë:

$$PD = 30\% + 25\% + 50\% = 100\%$$

## 5. Llogaritja e dëmshpërblimit për rrushin

### Llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit për temperaturat jashtëzakonisht të ulëta

Gjatë periudhës nga 1 dhjetori - 19 mars, rrushi mund t'i ekspozohet temperaturave jashtëzakonisht të ulëta, dhe si pasojë këto temperatura mund t'i shkaktojnë dëm rrushit. Pagesa e dëmshpërblimit do të llogaritet sipas numrit të ditëve të prekura dhe përqindjeve të dëmeve të përcaktuara në tabelën më lartë.

Kufiri i dëmshpërblimit për këtë periudhë të mbulimit llogaritet nga temperatura  $\leq -30^{\circ}\text{C}$ . Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-30^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 100% e kostos së prodhimit.

Në rast se temperatura minimale e ditës nuk është prekur, nuk do të ketë dëmshpërblim në dispozicion.

Formula për kalkulimin e dëmshpërblimeve si pasojë e temperaturave ekstreme dimërore për këtë periudhë të mbulimit është përshkruar më poshtë:

### **LID = n x PD për ditë**

**Shembull:** Nëse gjatë periudhës 1 dhjetor - 19 mars, temperaturat janë nën ose të barabarta me kufirin  $-30^{\circ}\text{C}$ , për 2 ditë, atëherë llogaritja do të jetë si në vijim:

$$2 \text{ ditë} \times 100\% = 100\%$$

Shuma maksimale e pagesës për polisën e sigurimit nuk mund të kalojë 100% e shumës së siguruar.

### Llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit për ngricat pranverore (Faza I)

Gjatë periudhës 20 mars - 9 prill, sythat e rrushit janë në rrezik nga faza e parë e ngricës pranverore dhe si pasojë mund të krijohen humbje të mëdha të rendimentit të rrushit. Pagesa e dëmshpërblimit do të llogaritet sipas numrit të ditëve të prekura dhe përqindjeve të dëmeve të përcaktuara në tabelën më lartë.

Kufiri i dëmshpërblimit për këtë periudhë të mbulimit llogaritet nga temperatura  $\leq -5^{\circ}\text{C}$ . Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-5^{\circ}\text{C}$  por më e lartë se  $-6^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 40% për çdo ditë. Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë  $-6^{\circ}\text{C}$  por më e lartë se  $-7^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 60%. Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-7^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 80%.

Në rast se temperatura minimale e ditës nuk është prekur, nuk do të ketë dëmshpërblim në dispozicion.

Formula për kalkulimin e dëmshpërblimeve si pasojë e ngricave pranverore për këtë periudhë të mbulimit është përshkruar më poshtë:

$$LID = \sum n((-rd(Tmin)) + (Trig)) \times PD + PD$$

Shembull: Nëse nga 20 marsi - 9 prill (gjatë periudhës së mbulimit për fazën e parë të ngricave pranverore) temperatura minimale ditore është  $-6.3^{\circ}\text{C}$  për një ditë, atëherë llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit do të bëhet si në vijim:

$$1((-rd(-6.3^{\circ}\text{C}) + (-6^{\circ}\text{C})) \times 60\% + 60\%) =$$

$$1((6 - 6) \times 60\% + 60\%) = 1((0 \times 60\% + 60\%) = 0\% + 60\% = 60\%$$

Shuma maksimale e pagesës për polisën e sigurimit nuk mund të kalojë 100% e shumës së siguruar.

Nëse i siguruari merr 100% të pagesës së dëmshpërblimit për cilëndo periudhë të rrezikut, nuk do të bëhet asnjë pagesë tjetër për rreziqet e tjera edhe nëse ka ndodhur ndonjë ngjarje tjetër e siguruar.

### Llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit për ngricat pranverore (Faza II)

Gjatë muajit 10 prill - 30 prill, sythat e rrushit janë në rrezik nga faza e dytë e ngricave pranverore dhe si pasojë mund të krijohen humbje të mëdha të rendimentit të rrushit. Pagesa e dëmshpërblimit do të llogaritet sipas numrit të ditëve të përqindjeve të dëmeve të përcaktuara në tabelën më lartë.

Kufiri për këtë periudhë të mbulimit fillon të llogaritet nga barabartë ose  $-2^{\circ}\text{C}$ . Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-2^{\circ}\text{C}$  por më e lartë se  $-3^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 25% për çdo ditë. Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-3^{\circ}\text{C}$  por më e lartë se  $-4^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 50% për çdo ditë. Nëse temperatura minimale ditore është më e lartë ose e barabartë me  $-4^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 70% për çdo ditë.

Në rast se temperatura minimale e ditës nuk është prekur, nuk do të ketë dëmshpërblim në dispozicion.

Formula për kalkulimin e dëmshpërblimeve si pasojë e ngricave pranverore për këtë periudhë të mbulimit është përshkruar më poshtë:

$$LID = \sum n((-rd(Tmin)) + (Trig)) \times PD + PD$$

Shembull: Nëse gjatë periudhës nga 10 prilli - 30 prill (gjatë periudhës së mbulimit për fazën II të ngricave pranverore) temperatura minimale ditore është  $-4.5^{\circ}\text{C}$  për një ditë, atëherë llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit do të bëhet si në vijim:

$$1((-rd(-4.5) + (-4)) \times 70\% + 70\%) =$$

$$1(4 - 4) \times 70\% + 70\% = 0 \times 70\% + 70\% = 70\%$$

Shuma maksimale e pagesës për polisën e sigurimit nuk mund të kalojë 100% e shumës së siguruar.

Nëse i siguruari merr 100% të pagesës së dëmshpërblimit për cilëndo periudhë të rrezikut, nuk do të bëhet asnjë pagesë tjetër për rreziqet e tjera edhe nëse ka ndodhi të tjera të nxitura.

### **Llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit për ngricat pranverore (Faza III)**

Gjatë muajit të majit, rrushi është në rrezik nga faza III e ngricave pranverore, dhe si pasojë lulet dhe frutet e rrushit mund të dëmtohen. Pagesa e dëmshpërblimit do të llogaritet sipas numrit të ditëve të prekuara dhe përqindjeve të dëmeve të përcaktuara në tabelën më lartë.

Kufiri për këtë periudhë të mbulimit fillon të llogaritet nga barabartë ose  $-1^{\circ}\text{C}$ . Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-1^{\circ}\text{C}$  por më e lartë se  $-2^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 25% për çdo ditë. Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-2^{\circ}\text{C}$  por më e lartë se  $-3^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 50% për çdo ditë. Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-3^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 80% për çdo ditë.

Në rast se temperatura minimale e ditës nuk është prekur, nuk do të ketë dëmshpërblim në dispozicion.

Formula për kalkulimin e dëmshpërblimeve si pasojë e ngricave pranverore për këtë periudhë të mbulimit është përshkruar më poshtë:

$$\text{LID} = \sum n((-rd(T_{\min})) + (\text{Trig})) \times \text{PD} + \text{PD}$$

Shembull: Nëse prej 1 maj - 14 maj temperatura minimale ditore është  $-1.2^{\circ}\text{C}$  për dy ditë, dhe një ditë  $-2^{\circ}\text{C}$ , atëherë llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit do të bëhet si në vijim:

$$2((-rd(-1.2^{\circ}\text{C}) + (-1^{\circ}\text{C})) \times 25\% + 25\%) + 1((-rd(-2) + (-2)) \times 50\% + 50\%) =$$

$$2((1 - 1) \times 25\% + 25\%) + 1((2 - 2) \times 50\% + 50\%) = 2(0 \times 25\% + 25\%) + 1(0 \times 50\% + 50\%) =$$

$$2 \times 25\% + 1 \times 50\% = 50\% + 50\% = 100\%$$

Shuma maksimale e pagesës për polisën e sigurimit nuk mund të kalojë 100% e shumës së siguruar.

Nëse i siguruari merr 100% të pagesës së dëmshpërblimit për cilëndo periudhë të rrezikut, nuk do të bëhet asnjë pagesë tjetër për rreziqet e tjera edhe nëse ka ndodhi të tjera të nxitura.

### **Pagesa totale e dëmshpërblimit**

Shuma maksimale e pagesës për polisën e sigurimit nuk mund të tejkalojë 100% e shumës së siguruar.

**IP = IF(llogaritja e dëmshpërblimit për fazën e temperaturave të ulëta ekstreme + llogaritja e dëmshpërblimit për fazën e I të ngricave pranverore + llogaritja e dëmshpërblimit për fazën II të ngricave pranverore + llogaritja e dëmshpërblimit për fazën III të ngricave pranverore) > 100%, ATËHERË 100%**

Bazuar në shembujt, pagesa totale e dëmshpërblimit do të jetë:

$$\text{IP} = 20\% + 60\% + 70\% + 100\% = 100\%$$



## 6. Llogaritja e dëmshpërblimit për kumbullën

### Llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit për ngricat pranverore (Faza I)

Gjatë periudhës 20 mars – 9 prill, sythat e pemës së kumbullës janë në rrezik nga ngricat pranverore dhe si pasojë mund të krijohen humbje të mëdha te rendimentit të kumbullës. Pagesa e dëmshpërblimit do të llogaritet sipas numrit të ditëve të prekura dhe përqindjeve të dëmeve të përcaktuara në tabelën më lartë.

Kufiri i dëmshpërblimit për këtë periudhë të mbulimit llogaritet nga temperatura  $\leq -5^{\circ}\text{C}$ . Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-5^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 10% e kostos së prodhimit, për secilën ditë dhe për secilën gradë.

Në rast se temperatura minimale e ditës nuk është prekur, nuk do të ketë dëmshpërblim në dispozicion.

Formula për kalkulimin e dëmshpërblimeve si pasojë e ngricave pranverore për këtë periudhë të mbulimit është përshkruar më poshtë:

$$\text{LID} = \sum n((-rd(T_{\min})) + (Trig)) \times PD + PD$$

Shembull: Nëse gjatë periudhës nga marsi – prill (gjatë periudhës së mbulimit për fazën I të ngricës pranverore) temperatura minimale ditore është  $-6.5^{\circ}\text{C}$  për 2 ditë dhe  $-5^{\circ}\text{C}$  për 2 ditë, atëherë llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit do të bëhet si në vijim:

$$1(((rd) (-6.5^{\circ}\text{C}) + (-5^{\circ}\text{C})) \times 10\% + 10\%) + 2(((rd) (-5^{\circ}\text{C}) + (-5^{\circ}\text{C})) \times 10\% + 10\%) =$$

$$1((6 - 5) \times 10\% + 10\%) + 2((5 - 5) \times 10\% + 10\%) =$$

$$1(1 \times 10\% + 10\%) + 2(0 \times 10\% + 10\%) =$$

$$1 \times 20\% + 2 \times 10\% = 40\%$$

Shuma maksimale e pagesës për polisën e sigurimit nuk mund të kalojë 100% e shumës së siguruar.

Nëse i siguruari merr 100% të pagesës së dëmshpërblimit për cilëndo periudhë të rrezikut, nuk do të bëhet asnjë pagesë tjetër për rreziqet e tjera edhe nëse ka ndodhi të tjera të nxitura.

### Llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit për ngricat pranverore (Faza II)

Gjatë periudhës 10 prill – 30 prill, sythet dhe lulet e pemës së kumbullës janë në rrezik nga ngricat pranverore dhe si pasojë mund të krijohen humbje të mëdha te rendimentit të kumbullës. Pagesa e dëmshpërblimit do të llogaritet sipas numrit të ditëve të prekuara dhe përqindjeve të dëmeve të përcaktuara në tabelën më lartë.

Kufiri për këtë periudhë të mbulimit fillon të llogaritet nga barabartë ose  $-4^{\circ}\text{C}$ . Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-4^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 25% për çdo ditë. Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-5^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 50% për çdo ditë. Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-6^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 100% për ditë.

Në rast se temperatura minimale e ditës nuk është prekur, nuk do të ketë dëmshpërblim në dispozicion.

Formula për kalkulimin e dëmshpërblimeve si pasojë e ngricave pranverore për këtë periudhë të mbulimit është përshkruar më poshtë:

$$LID = \sum n((-rd(Tmin)) + (Trig)) \times PD + PD$$

Shembull: Nëse nga 1 maji - 15 maj (gjatë periudhës së mbulimit për fazën I të ngricave pranverore) temperatura minimale ditore është  $-4.9^{\circ}\text{C}$  për një ditë, atëherë llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit do të bëhet si në vijim:

$$1((-rd) (-4.9^{\circ}\text{C}) + (-4^{\circ}\text{C})) \times 25\% + 25\% =$$

$$1(0 \times 25\% + 25\%) =$$

$$0 + 25\% = 25\%$$

### Llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit për ngricat pranverore (Faza III)

Gjatë muajit maj, lulet dhe frutat e kumbullave janë në rrezik nga ngricat pranverore dhe si pasojë mund të krijohen humbje të mëdha të rendimentit të kumbullës. Pagesa e dëmshpërblimit do të llogaritet sipas numrit të ditëve të prekuara dhe përqindjeve të dëmeve të përcaktuara në tabelën më lartë.

Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-1^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 25% për çdo ditë. Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-2^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 50% për çdo ditë. Nëse temperatura minimale ditore është më e ulët ose e barabartë me  $-3^{\circ}\text{C}$ , pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 100% për ditë.

Në rast se temperatura minimale e ditës nuk është prekur, nuk do të ketë dëmshpërblim në dispozicion.

Formula për kalkulimin e dëmshpërblimeve si pasojë e ngricave pranverore për këtë periudhë të mbulimit është përshkruar më poshtë:

$$LID = \sum n((-rd(Tmin)) + (Trig)) \times PD + PD$$

Shembull: Nëse gjatë majit (gjatë periudhës së mbulimit të fazës III të ngricave pranverore) temperatura minimale ditore është  $-1.2^{\circ}\text{C}$  për dy ditë, dhe për një ditë  $-2^{\circ}\text{C}$ , atëherë llogaritja e pagesës së dëmshpërblimit do të bëhet si në vijim:

$$2((-rd) (-1.5^{\circ}\text{C}) + (-1^{\circ}\text{C})) \times 25\% + 25\% + 1((-rd) (-2) + (-2)) \times 50\% + 50\% =$$

$$2((1-1) \times 25\% + 25\%) + 1(2-2) \times 50\% + 50\% =$$

$$2(0 \times 25\% + 25\%) + (0 \times 50\% + 50\%) =$$

$$50\% + 50\% = 100\%$$

### Pagesa totale e dëmshpërblimit

Shuma maksimale e pagesës për polisën e sigurimit nuk mund të kalojë 100% e shumës së siguruar.

$IP = IF(\text{llogaritja e dëmshpërblimit për fazën I të ngricave pranverore} + \text{llogaritja e dëmshpërblimit për fazën II të ngricave pranverore} + \text{llogaritja e dëmshpërblimit për fazën III të ngricave pranverore}) > 100\%$ , ATËHERË 100%

Bazuar në shembujt, pagesa totale e dëmshpërblimit do të jetë:  $PD = 40\% + 25\% + 100\% = 100\%$

## **METODA E PAGESËS SË KËRKESËS**

Kërkesat do të paguhen drejtpërsëdrejti në xhirollogarinë bankare të të sigurvearit, e shkruar në formularin e aplikimit.

## **ANKESAT**

Siguruesit duhet të krijojnë një zyrë ku adresohen kërkesat e klientëve. Klientët e pakënaqur duhet të referojnë rastet e tyre tek Siguruesi.

Klientët e pakënaqur me mënyrën ose shumën e pagesës së dëmshpërblimit kanë të drejtë të ankohen në Kompaninë e tyre të Sigurimit. Siguruesi duhet t'i udhëzojë ata që të ndjekin procedurat e parashikuara për ankesë. DMR-ja do të ketë një rol monitorues dhe ndërmjetësues në zgjidhjen e problemeve midis fermerëve dhe kompanive të sigurimeve.